



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-079

Prishtinë, më 15 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 15 TETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Lutfi Haziri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8 tetor 2012,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave,
4. Të ndryshme.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 tetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 tetor 2012.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Në fillim të mbledhjes, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, propozoi që Kuvendi në mbledhjen plenare të radhës ta miratojë një rezolutë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Në vazhdim, Adem Grabovci e arsyetoi nevojën për nxjerrjen e rezolutës së lartshënuar.

Lidhur me propozimin e Adem Grabovcit diskutuan: kryetari, Ardian Gjini, Visar Ymeri, Lutfi Haziri dhe Glauk Konjufca.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia vendosi që Propozim-rezoluta e propozuar nga Grupi Parlamentar i PDK-së të radhitet në rend dite të mbledhjes plenare, më 18 tetor 2012.

Në vazhdim, Kryesia, pasi diskutoi për pikat e propozuara, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy mbledhje plenare.

Mbledhja plenare, më 17 tetor 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës.

Mbledhja plenare, më 18 tetor 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondit Monetar Ndërkombëtar,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe
10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011.

* * *

Gjithashtu, Kryesia u njoftua me kërkesën e ministrit të Shëndetësisë, z.Ferid Agani, për shtyrjen për një javë të shqyrtimit të Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe Projektligjin për kontrollin e duhanit.

Kryesia, me kërkesë të ministrit Ferid Agani, vendosi që dy projektligjet e lartshënuara, të shtyhen për mbledhjen tjetër të radhës.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

3.1 Ratifikimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe Universitetit të Pejës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me ratifikimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe Universitetit të Pejës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional, që ta shqyrtojë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit si institucion publik i arsimit të lartë dhe vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për themelimin e Universitetit Publik të Pejës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale